



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.375/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, në çështjen kontestuese të paditëses Kompania e Sigurimeve “I...” me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson F.K., kundër të paditurit M.E. nga fsh.../Vushtrri, për rimbursim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.305/14 të dt.03.10.2019, në seancën e kolegjit e mbajtur me datë 28.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurit M.E. nga fsh.../Vushtrri, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.305/14 i dt.03.10.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit, obligohet i padituri M.E. nga fsh.../Vushtrri, që në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jo material, paditëses Kompania e Sigurimeve KS “I...” me seli në Prishtinë, t’ia paguaj shumën prej 3,618 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën paralajmërimin e përmbarimit të detyrueshëm. Me të njëjtin aktgjykim në pikën II të dispozitivit, është vendosur që, secila palë i bartë shpenzimet e saj të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor i padituri ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësja ka parashtruar padi kundër të paditurit, duke kërkuar nga gjykata, për rimbursimin e dëmit material dhe jo material, që paditësja ua ka kompensuar nga aksidenti i dt.05.02.2010, me nr.2010-BR-071 në fsh. .../Vushtrri, të dëmtuarve F., L. dhe A., të gjithë me mbiemrin E., në shumën totale prej 3,618€. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditëses ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, me propozim që të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Shpenzimet dhe kamatën ligjore nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat dhe i ka vlerësuar ato dhe në përfundim ka marrë aktgjykimin, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me detaje të tjera të përshkruara më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, ndër të tjera ka konstatuar se, nuk është kontestues fakti se me dt.05.02.2010, në fshatin .../Vushtrri, i padituri përderisa ishte duke ngarë automjetin dhe nuk posedonte patentë shofer, është vet aksidentuar, ndërsa në automjet prezentë kanë qenë edhe A., L. dhe F. E., të cilët kanë pësuar lëndime trupore dhe nuk është kontestues fakti që në marrëveshje me paditësen të njëjtit janë kompensuar në shumë totale prej 3,618€. Gjykata lidhur me përgjegjësinë e të paditurit, iu ka referua Ligjit për Sigurimin nga Auto përgjegjësia nr.04/L-018, ku nga baza ligjore gjeti se, i padituri në ditën kritike ka drejtuar automjetin pa patentë shofer dhe dëmin e shkaktuar të kompensuar nga paditësja, ka për obligim që të rimburoj, sepse konsiderohet se mbulesa siguruese i ka humbur dhe nuk ka qenë valide. Lidhur me lartësinë e rimbursimit, gjykata e shkallës së parë iu referua marrëveshjes së arritur mes palëve të dëmtuara dhe kompanisë, me marrëveshje jashtëgjyqësore. Krejt në fund, meqenëse paditësja ka deklaruar se është tërhequr nga shpenzimet procedurale dhe kamatën, gjykata ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Këtë gjendje faktike të çështjes gjykata e ka bazuar në dispozita e nenit 9 par.1.3, 14 par.1 nënpar.1.2 dhe par 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, nenit 17 dhe 245 par.1 të LMD-së, si dhe nenit 450 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurit, për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, duke mos i theksuar shkeljet konkrete dhe dispozita e shkelura të procedurës, por megjithë atë Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakuar e vlerësoj edhe sipas detyrës zyrtare dhe erdhi në përfundim se aktgjykimi i atakuar është i kuptueshëm, dispozitivi i tij është i qartë dhe në harmoni të plotë me arsyetimin e dhënë, e në të cilin arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshëm, konkrete për faktet me rëndësi vendimtare, të cilat kanë pasur ndikim për marrjen e një aktgjykimi të tillë, e të cilat gjykata e shkallës së parë i ka elaboruar mjaft mirë në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar.

Prandaj, në këtë çështje kontestimore, ku baza juridike e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese, pastaj provat të cilat ekzistojnë në shkresat e kësaj lënde janë ekzaminuar, ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 8 të LPK-së, pra, në këtë aspekt është vepruar edhe në pajtim me dispozitën e nenit 322 të LPK-së, ashtu që pretendimet ankimore në këtë aspekt janë të pa bazuar dhe njëkohësisht të pa qëndrueshme, dhe si të tilla u refuzuar nga kjo gjykatë.

Gjithashtu nuk qëndron pretendimi ankimor për shkelje të dispozitave kontestimore nga neni 14 të LPK-së, sepse fakti se i padituri ka shkaktuar aksidentin nuk është kontestuese, pasi që edhe vet i padituri ka deklaruar se është vet aksidentuar, e po ashtu ekziston edhe raporti policor 2010-BR-071 të dt.05.02.2010 dhe se me rastin e këtij aksidenti lëndime trupore kanë pësuar pasagjeret, përkatësisht gruaja dhe fëmijët e të paditurit. Kështu që fajësia dhe përgjegjësia e të paditurit, është evidente dhe nuk ka vend për kontestimin e sajë, edhe për kundër asaj se nuk kemi ndonjë aktgjykim penal, sepse sikur mos të ishin familjarë të paditurit të dëmtuarit, me siguri se do të ekzistonte edhe aktgjyrimi penal, mirëpo në rastin konkret nuk ka ndonjë relevancë. Bazuar në këtë gjendje faktike ekzistuese edhe gjykata e shkallës së parë, e ka vërtetuar me prova konkrete gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore të paditëses, ashtu që pretendimi ankimor në këtë aspekt nuk qëndron, nga se është i pa bazuar.

Po ashtu, është i paqëndrueshëm edhe pretendimi ankimor, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale në dëm të paditurës me aktgjykimin e atakuar, sepse gjykata e shkallës së parë, qartë është sqaruar në aktgjykimin e saj, se përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga i padituri, i cili nuk ka poseduar patentë shofer, i takon të paditurit të rastit konkret, bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia. Kështu që, me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë është konstatuar se, i padituri nuk kishte patentë shofer dhe se të dëmtuarit të cilët në ato momente kanë qenë pasagjer, për dëmin e shkaktuar janë kompensuar nga paditësja dhe se tani paditësja ka të drejtë regresi, pra i padituri, është i obliguar që të rimbursoj paditësen për dëmin e shkaktuar, ndërsa lidhur me lartësinë e kërkesës së sajë, nuk ka propozuar asnjë provë, për ta vërtetuar ndonjë gjendje tjetër, e cila do të ishte e kundërt me këtë të cilën e ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë.

Prandaj, Gjykata e Apelit, vlerëson se, pretendimet ankimore e të paditurit, përgjithësisht janë të pabazuara, sepse baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar raportin policor 2010-BR-071 të dt.05.02.2010, ku theksohet se, i padituri ka drejtuar automjetin pa poseduar patentë shofer dhe i cili ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe është vet aksidentuar, e duke iu shkaktuar lëndime trupore pasagjereve, respektivisht gruas së tij F. E. dhe fëmijëve L. dhe A. E., të cilët janë kompensuar nga paditësja me marrëveshje jashtë gjyqësore, në shumat e caktuara për secilin veç e veç, e në shumë totale prej 3,618€, me detaje si në shkresat e lëndës. Propozim lidhur me marrjen e ndonjë ekspertize, nga i padituri nuk ka pasur, kështu që pretendimet në këtë drejtim nuk kanë bazë.

Në këtë drejtim Gjykata e Apelit vlerëson se, pasi që gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar plotësisht dhe drejtë gjendjen faktike, po ashtu drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, kur në vendimin e saj me të drejtë i referohet dispozitave ligjore të cilat kanë qenë të aplikueshme në kohën e shkaktimit të dëmit nenit 9 par.1.3, 14 par.1 nënpar.1.2 dhe par.3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia dhe 17 dhe 245 të LMD-së, si dhe nenit 450 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Me dispozitën e nenit 24 të LSDA-së në mënyrë decidive parashihet se, *“i siguruari e humb mbulesën siguruese përveç tjerash edhe kur drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit”*, ndërsa me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se *“siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe par.3 i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkoj rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”*

Gjykata e Apelit vlerëson se, shkaktimi i dëmit është kushti me rendësi për lindjen e detyrimeve dhe se shkaktimi i dëmit si fakt juridik paraqet rrethanë të caktuar, e cila sjellë deri te krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies së detyrimeve, pra, për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, ndër kushtet e përgjithshme është edhe lidhja kauzale, që ekziston në mes veprimit ose mos veprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Të gjitha këto kushte në rastin konkret janë plotësuar.

Prandaj, sipas Gjykatës së Apelit, përgjithësisht pretendimet ankimore të paditurit, ishin të pa bazuara, pa mbështetje në prova konkrete dhe dispozita ligjore dhe si të tilla u refuzuan në tërësi, ndërsa qëndrimi juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të drejtë dhe të ligjshëm në tërësi e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.375/2020 me dt.28.07.2021

Kryetari i kolegjit-gjykatësi
Gëzim Llulluni